



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K2/I11-7 Prot.
Nr. Dok. 202502920/7

Tiranë _11/_12_/2025

Lënda: *Rekomandim i përgjithshëm për marrjen e masave të cilat garantojnë zhvillimin e hetimeve objektive, të gjithanshme dhe të shpejta, në respektim të procesit të rregullt ligjor, nisur nga shqyrtimi i rastit të procedimit penal nr.1407/2012, regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.*

MINISTRISË SË DREJTËSISË
Tiranë

KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË
Tiranë

PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË
Tiranë

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
Korçë

Të nderuar!

Respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor përfshirë këtu të gjitha aspektet që lidhen me garantimin efektiv të kësaj të drejte, ku vlen të përmendim dhe procedurat paraprake hetimore, kanë zënë një vend të rëndësishëm në numrin e ankesave të adresuara gjatë vitit 2025 nga shtetas të ndryshëm në adresë të Avokatit të Popullit. Çdo shtetas ka të drejtë që çështja e tij të hetohet dhe gjykohet drejtësisht, brenda një afati të arsyeshëm, dhe të informohet për ecurinë e hetimit ashtu siç Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Kushtetuta dhe Legjislacioni penal parashikon.

Në këtë rekomandim, i referohemi një rasti konkret të trajtuar me iniciativë nga Avokati i Popullit, bazuar në nenin 13, paragrafi i parë i Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”*.

I. Parashtrimi i rastit.

Institucioni i Avokatit të Popullit është njohur nga media vizive (Emisioni STOP në kanalin kombëtar televiziv Klan) më datën 16.06.2025¹, lidhur me ngjarjen e rëndë të ndodhur në Vloçisht të Korçës në vitin 2012, ku u gjend i vrarë me armë zjarri në ambientet e lokalit që kishte marrë me qera, shtetasi H. H.

Sipas këtij lajmi, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë kishte nisur procedimin penal me nr.1407/2012 ndaj një personi të akuzuar për vrasjen, konkretisht shtetasin E. K., person i cili kishte humbur një sasi të madhe parash në lojrat e fatit instaluar në ambientet e lokalit të viktimës H. H. Në kuadër të këtij procedimi, organi i prokurorisë ndër veprimet e tjera hetimore ka kërkuar dhe kryerjen e aktit të ekspertimit kimik nga Instituti i Policisë Shkencore Tiranë. Në aktin e ekspertimit kimik nr. 349, dt. 11.01.2013, kryer në Institutin e Policisë Shkencore Tiranë, është shprehur: *“Në bluzën objekt ekspertimi të shtetasit E. K., janë evidentuar prania e nitriteve dhe nitrateve të cilat janë të pranishme dhe te mbeturinat e faktorëve plotësues të qitjes por nuk mund të shprehem nëse kanë ardhur si rezultat i qitjes me armë zjarri, procesit të saldimet që pretendohet nga i akuzuari apo ndonjë procesi tjetër teknologjik.”*

Në këto kushte organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, konkretisht prokurori G. S. ka vendosur në datën 05.12.2013 pezullimin e çështjes me arsyetimin e mungesës së provave.

Me insistimin e djalit të viktimës, shtetasit E. H. dhe gazetarit të emisionit STOP, me sigurimin e disa provave të reja përfshirë dhe dëshmitarë okularë të ngjarjes, organi i

¹ Link: <https://www.youtube.com/watch?v=jeWtsE1AmMQ>

prokurorisë në maj të viti 2017 e rihapi çështjen lidhur me këtë ngjarje. Me rihapjen e hetimeve organi i prokurorisë i është drejtuar përsëri me kërkesë për kryerjen e riekspertimit kimik sipas vendimit të datës 29.03.2018 IPSH-së. Instituti i Policisë Shkencore Tiranë në datën 17.04.2018 nëpërmjet aktit të riekspertimit është shprehur ndër të tjera se: “Në IPSH aktualisht nuk mund të marrim modele nga teshat pasi marrja e modeleve nga teshat kërkon një mënyrë të veçantë për të shmangur konkluzionet e gabuara. Ne sugjerojmë laboratorin e Irlandës pasi aty kanë përvojë të drejtëpërdrejtë për këtë lloj ekzaminimi por ka dhe laboratorë të tjerë ku mund të drejtoheni si Greqi, Kroaci, Gjermani, etj.” Organi i akuzës, konkretisht prokurore O. V. ka vendosur përsëri më datën 28.05.2018 pezullimin e hetimeve për këtë rast për mungesë provash. Pra konstatohet që në këtë rast organi i akuzës ka vendosur të pezullojë çështjen dhe jo të kërkojë një ekzaminim jashtë vendit në kuadër të ndihmës juridike të ndërsjelltë, bazuar në Konventën Europiane “Për ndihmën e ndërsjelltë gjyqësore për çështjet penale”.

Me insistimin e trashëgimtarëve të viktimës dhe emisionit investigativ është rihapur çështja në vitin 2021 nga prokuror D. N. i cili ka kërkuar që në kuadër të ndihmës juridike të ndërsjelltë, t’i drejtohet me letërporosi autoriteteve Greke për të kryer një ekzaminim kimik më të thelluar.

Ende dhe sot, pas **më shumë se 8 (tetë) vitesh** familjarët e viktimës, nuk kanë informacion përsa i përket ecures së këtij hetimi dhe vënies përpara drejtësisë të personit që shkaktoi këtë ngjarje me një viktimë 13 (trembëdhjetë) vite më parë.

Avokati i Popullit, një institucion i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ky rast i bërë publik, plotëson të gjithë kushtet për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore për trajtim.

Në kuadër të procedurës së hetimit administrativ të çështjes, me shkresën nr. K2/I12-2 Prot. datë 01.07.2025 “Kërkesë për informacion”, i kërkuam informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë lidhur me veprimet hetimore të kryera për këtë çështje, veprimet dhe procedurat që mund të kishin ndërmarrë në vijim, si dhe nëse ishin mbajtur të informuar trashëgimtarët e viktimës lidhur me ecurinë e hetimeve dhe vendimmarrjen e organit të prokurorisë.

Organi i prokurorisë në përgjigjen e tij me shkresën nr. 8529 prot.(V.P) datë 16.07.2025 na bën me dije se:

- Lidhur me procedimin penal nr.1407/2012, prokurori G. S. me vendimin e datës 05.12.2013 ka vendosur pezullimin e hetimeve për mungesë provash.
- Pas pamjeve të transmetuara në emisionin STOP të TV Klan me vendimin e datës 13.06.2017 të prokurores O. V. kanë rifilluar hetimet dhe po kjo prokurore në datën 28.05.2018 ka vendosur përsëri pezullimin e hetimeve për mungesë provash.
- Nisur dhe një herë nga të dhënat e publikuara nga emisioni STOP çështja ka rifilluar hetimet me prokuror D. N. i cili në kuadër të hetimit, në vitin 2021 ka kërkuar ndihmë

juridike drejtuar autoriteteve greke për të kryer një akt ekspertimi të veshjes së personit të dyshur. Komunikimet me autoritetet greke kanë vazhduar deri më sot dhe ende nuk disponohet akti i ekspertimit.

- Aktualisht çështja i ka kaluar prokurores V.P. Pritet një përgjigje nga Ministria e Drejtësisë lidhur me letërporosinë.

Nisur nga informacioni i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, ku ndër të tjera shprehet se nuk kishte një përgjigje të kërkesës drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për ecurinë e procedurës me autoritet greke në kuadër të ndihmës juridike, iu drejtua ministrisë me shkresën nr. K2/I12-4Prot. datë 26.09.2025 “Kërkesë për informacion”.

Në përgjigje të shkresës tonë cituar më lartë, jemi informuar nga Ministria e Drejtësisë me shkresën me nr. 4809/1 prot. datë 07.10.2025 “Kthim përgjigje” se, ende **nuk kishte një përgjigje nga autoritetet greke lidhur me ekzekutimin e letërporosisë lidhur me këtë rast.** Bashkëlidhur me përgjigjen Ministria e Drejtësisë na ka vënë në dispozicion dhe një kopje të dokumentacionit për të qartësuar korespondencën ndërinstitucionale për rastin në fjalë.

Në shqyrtim të dokumentacionit të përcjellë nga Ministria e Drejtësisë vihet re se:

- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm i ka dërguar Ministrisë së Drejtësisë letërporosinë datën 22.06.2021, e cila përmbanë kërkesën për ndihmë juridike me detajet që kërkohej lidhur me aktin ekspertimit kimik si dhe citohet që bashkëlidhur është dhe prova materiale (*një bluzë e personit të akuzuar*) e cila kërkohej të ekzaminohet.
- Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 2647/1prot.MD, datë 28.06.2021 “ Kthim përgjigje” i drejtohet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë ku i tërhiqet vëmëndja se bashkëlidhur shkresës mungon objekti i ekspertimit kimit.
- Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 2647/3Prot. MD, datë 14.07.2021 “Kërkesë për ndihmë juridike” i përcjell autoriteteve greke letërporosinë.
- Më pas organi i prokurorisë Korçë i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. 3228 prot.VM datë 21.06.2023 “Kërkohej informacion lidhur me ndihmën juridike drejtuar autoriteteve greke për procedimin penal nr.1407/2012”, kërkesë e bërë pas 2 vitesh nga përcjellja e letërporosisë.
- Shkresa nr.2275/1prot.BK datë 24.07.2023 “Kërkesë për ndihmë juridike” e Min. Drejtësisë drejtuar autoriteteve greke, ku vërehet referenca gabim e veprës penale lidhur me procedimin penal nr.1497/2021.
- Shkresa e autoriteteve greke datë 31.10.2023 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë ku shprehet se veprimet që kërkoni për tu kryer nuk përputhen me çështjen që trajtohet në shkresën nr. 2275/1 dt.24.07.2023. dhe shkresën nr. 3228 prot.VM datë 21.06.2023.
- Shkresa e datës 06.09.2024 “ Mosekzekutim i letërporosisë së Autoriteteve të Shqipërisë” ku arsyehet se letërporosia e cila shpjegon aktin e ekspertimit që kërkohet të kryhet është përcjellë vetëm në gjuhën shqipe.

- Shkresa nr.1516/1 prot. BK datë 23.06.2025 e Ministrisë së Drejtësisë drejtuar autoriteteve greke, ku i kërkon kthimin e provës materiale e cila ka lidhje me ekzaminimin në kuadër të procedimit penal nr.1407/2021.

Nga kjo korespondencë del qartazi se për më shumë se 4 (katër) vite nuk është realizuar disponimi i aktit të ekspertizës kimike, si një nga provat kyçe në këtë procedim penal, si rezultat i mangësive dhe dërgimit të paplotë të kërkesave nga institucionet shqiptare.

II. Konstatimet dhe Vlerësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me rastin.

Avokati i Popullit në shqyrtim dhe vlerësim të informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga organi i prokurorisë Korçë dhe Ministria e Drejtësisë vëren se:

Së pari; në përgjigjen e ardhur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nuk kemi marrë përgjigje të disa kërkesave tona si përshebull, nëse ishin informuar palët për veprimet hetimore, për provat, për vendimmarrjen e pezullimit dhe të drejtën e tyre për ankimim. Çfarë veprimesh hetimore ishin kryer gjatë periudhës së pezullimit dhe rihapjes së çështjes. Nuk kemi asnjë kopje dokumentacioni bashkëlidhur që të vërtetonte veprimet e prokurorit në raport me pretendimet e palëve, të cilët shprehen se nuk kishin informacion as për shtyrjen e afateve të hetimit, si dhe për veprimet apo vendimmarrjet e prokurorisë.

Evidentohet fakti se subjekti që ka vënë në lëvizje për të disatën herë këtë procedim penal nëpërmjet denoncimit publik dhe publikimit të fakteve lidhur me ngjarjen, konkretisht në emisionin televiziv STOP në TV Klan, ka qënë familja e viktimës.

Ky fakt na çon të mendojmë se veprimet hetimore të ndërmarra nga organet e prokurorisë dhe të policisë gjyqësore nuk kanë qënë në nivelin e duhur për të zbardhur të vërtetën mbi ngjarjen. Gjithashtu, mungon transparenca lidhur me llojin dhe numrin e veprimeve hetimore që prokuroria ka kryer gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore. Mungesa e informacionit të plotë në përgjigje të kërkesës sonë për detajet e hetimeve na shtyn të besojmë se nga ana e organit të akuzës nuk janë kryer hetime të plota, efektive dhe gjithëpërfshirëse.

Nga analiza e fakteve të paraqitura, përfshirë pezullimin e përsëritur të procedimit për mungesë provash, rihapjen e çështjes mbi bazën e indicieve mediatike, si dhe zvarritjen e procedurave hetimore përtej afateve të arsyeshme, krijohet përshtypja se cilësia e hetimeve ka qënë e ulët. Kjo tregon për një prirje të prokurorisë drejt kryerjes formale të disa procedurave paraprake, pa ndërmarrë veprime thelbësore për zbardhjen e plotë të çështjes. Në të dy vendimmarrjet për pezullimin e hetimeve vihet re se organi i prokurorisë është mjaftuar me përgjigjen e IPSH-së në pamundësinë e kryerjes së aktit të ekspertimit kimik. Ndërkohë nisur nga fakti se ky akt përbën një provë nga më të rëndësishmet në procesin hetimor, bazuar në nenin 179/3 të K.Pr. Penale “Caktimi i ekspertit” i cili përcakton shprehimisht: “kur kërkimet dhe vlerësimet paraqiten shumë komplekse ose kërkojnë njohuri të ndryshme në disa degë, organi procedues i ngarkon kryerjen e ekspertimit disa ekspertëve.

*Në raste të veçanta, kur ekspertimi nuk mund të kryhet nga lista e ekspertëve të regjistruar pranë gjykatës, organi procedues, pasi merr paraprakisht mendimin e palëve, cakton ekspertë të tjerë, vendas ose të huaj, jashtë kësaj liste.”, organi i prokurorisë mund të kishte ndërmarrë më herët se **viti 2021** vendimin për t’ju drejtuar ekspertëve të huaj.*

Avokati i Popullit, ka mirëkuptuar dhe vlerësuar volumin e punës dhe vështirësitë me të cilat po përballen aktualisht strukturat e organeve të drejtësisë për shkak të mungesave në burimet njerëzore, pjesë e këtij procesit ka qënë dhe largimi i dy prokurorëve përmendur në këtë rast², por mbështet qëndrimin se aksesimi në drejtësi dhe zbatimi me rigorozitet i parimeve bazë të një procesi të rregullt ligjor, duhet të udhëheqin punën dhe veprimtarinë e organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.

Ky procedim penal ka filluar në vitin 2012 ndërkohë që largimet kanë ndodhur kohë më vonë, në vitet 2021 dhe 2024. Kjo ngjarje me humbje jete kërkon një reagim dhe ndërveprim të shpejtë dhe efektiv, çdo person (*referohemi në këtë rast familjarëve të viktimës*) ka të drejtë që çështja e tij të hetohet dhe gjykohet drejtësisht, dhe brenda një afati të arsyeshëm nga strukturat e sistemit të drejtësisë.

Së dyti; Nisur nga të dhënat e analizuara në këtë rast, por edhe nga raste të tjera të evidentuara apo të bëra publike nga media e shkruar dhe ajo audiovizive, vërehet se struktura e Institutit të Policisë Shkencore (IPSH), për shkak të mungesës së investimeve të mjaftueshme, ka hasur shpesh në pamundësi për të realizuar aktet e ekspertimit në përputhje me kërkesat e organeve të drejtësisë. Ky problem prek drejtpërdrejt cilësinë e procesit hetimor dhe, për pasojë, të gjithë ecurinë e procesit penal.

Në rastin konkret, akti i ekspertimit kimik i kërkuar nga organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë në një procedim penal me një viktimë, përbën një provë të domosdoshme dhe thelbësore për zhvillimin e mëtejshëm të hetimeve. Sipas përcaktimeve të nenit 178 të Kodit të Procedurës Penale, “Objekti i ekspertimit”, dhe të nenit 185, “Akti i ekspertimit”, legjislatori i ka dhënë kësaj prove një rëndësi të veçantë në procesin hetimor penal, duke e konsideruar si mjetin që garanton vërtetësinë shkencore të fakteve dhe provave materiale.

Në shkresën nr. 7891/1 prot., datë 13.12.2019, të IPSH-së drejtuar Prokurorisë Korçë, në lidhje me aktin e ekspertimit kimik nr. 10305, datë 22.12.2012, të Drejtorisë së Policisë Shkencore Tiranë, evidentohen qartë kufizimet teknike dhe materiale të institucionit. Në këtë shkresë theksohet se “metoda që përdoret në këtë rast nga IPSH-ja kërkon marrjen e modeleve nga personat në duar dhe në fytyrë, por jo në rroba (tesha), siç kërkohet në rastin konkret, pasi kërkohen pajisje të tjera që aktualisht nuk disponohen nga Instituti”. Po ashtu,

² <https://dosja.al/aktualitet/kpa-mban-ne-fuqi-vendimin-e-kpk-shkarkohet-gentian-stoja-i317168>
<https://shqiptarja.com/lajm/shkarkohet-nga-kpk-prokurori-i-korces-dashnor-nure>

sqarohet se “në rastin konkret nuk mund të bëhen analiza të thelluara dhe nuk kemi mundësi të përpunimit paraprak të modeleve të marra nga teshat”.

Ky konstatim tregon qartë nevojën urgjente për modernizimin e infrastrukturës së IPSH-së, për përmirësimin e bazës teknike dhe për trajnimin e vazhdueshëm të stafit profesional. Investimi në këtë sektor duhet të konsiderohet prioritet kombëtar, pasi përbën një hallkë themelore në mbështetjen shkencore të organeve të drejtësisë, në zbardhjen e veprave penale dhe në identifikimin e autorëve të krimeve. Vetëm përmes një infrastrukture të përparuar dhe një trupe ekspertësh të kualifikuar mund të sigurohet një proces hetimor i drejtë, efikas dhe në përputhje me standardet bashkëkohore të drejtësisë penale.

Së treti; Në shqyrtimin e përgjigjes së ardhur nga Ministria e Drejtësisë, shoqëruar dhe me kopje të dokumentacionit, konstatohet se **mosardhja e përgjigjes së letër porosisë nga autoritet greke për aktin e ekspertimit për më shumë se 4 (katër) vite, në të shumtën e kohës është rezultat i mangësive dhe dërgimit të paplotë të kërkesave dhe provave nga ana e institucioneve tona të drejtësisë**³.

Në vlerësimin dhe gjykimin e Avokatit të Popullit, konstatohet një mungesë e harmonizimit të punës së përbashkët ndërinstitucionale, prokurori-Ministri e Drejtësisë, keqadministrim i procedurave hetimore, fillimisht nga ana e organit të prokurorisë sa përsa i përket hartimit të materialeve për të cilat kërkohet letërporosia dhe veprimeve aktive për të mundësuar dorëzimin e aktit të ekspertimit. Vetëm pas 2 (dy) viteve nga dërgimi i letërporosisë, prokuroria dërgon shkresë në Ministrinë e Drejtësisë ku kërkon informacion lidhur me ecurinë e ndihmës juridike. Gjithashtu dhe Ministria e Drejtësisë në shumë nga korespondencat **nuk** ka dërguar procedurën e plotë dhe të saktë sipas kërkesës së organit të prokurorisë si dhe në përputhje me dispozitat e Konventës Europiane “Për ndihmën e ndërsjellë gjyqësore për çështjet penale”.

Ne nuk po shqyrtojmë elementët themelorë që lidhen me veprimet procedural hetimore, të cilat mbeten në diskrecionin e prokurorit të çështjes, duke respektuar pavarësinë e tij në trajtimin e çështjes penale. Megjithatë, përmes shqyrtimit tonë administrativ synojmë të evidentojmë mangësitë e dukshme në punën dhe administrimin e procesit penal, të cilat çojnë në zvarritje përtej afateve ligjore dhe atyre të arsyeshme të hetimit.

³ shkresa nr. 2647/3Prot. MD, datë 14.07.2021 “ Kërkesë për ndihmë juridike” drejtuar autoriteteve greke.
shkresa nr. 2647/1prot.MD, datë 28.06.2021 “ Kthim përgjigje” drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë ku i tërhiqet vëmendja se bashkëlidhur shkresës **mungon objekti i ekspertimit kimit**
shkresa nr. 3228 prot.VM datë 21.06.2023 “ Kërkohet informacion lidhur me ndihmën juridike drejtuar autoriteteve greke për procedimin penal nr.1407/2012 e Prokurorisë pranë GJSHI Korçë, **kërkesë e bërë pas 2 vitesh nga përpjellja e letër porosisë.**
shkresa nr.2275/1prot.BK datë 24.07.2023 “ Kërkesë për ndihmë juridike” e Min. Drejtësisë drejtuar autoriteteve greke, **ku vërehet referenca gabim e veprës penale lidhur me procedimin penal nr.1497/2021.**
shkresa e autoriteteve greke datë 31.10.2023 drejtuar Ministrisë së Drejtësisë ku shprehet **se veprimet që kërkoni për tu kryer nuk përputhen me çështjen që trajtohet** në shkresën nr. 2275/1 dt.24.07.2023. dhe shkresën nr. 3228 prot.VM datë 21.06.2023.
shkresa e datës 06.09.2024 “ Mosekzekutim i letërporosisë së Autoriteteve të Shqipërisë” **ku arsyetja e përmendur është se letërporosia e cila shpjegon aktin e ekspertimit që kërkohet të kryhet është përcjellë vetëm në gjuhën shqipe.**
shkresa nr.1516/1 prot BK datë 23.06.2025 e Ministrisë së Drejtësisë drejtuar autoriteteve greke, ku i kërkon kthimin e provës materiale e cila ka lidhje me ekzaminimin në kuadër të procedimit penal nr.1407/2021.

Gjykimi i vendimeve të prokurorit apo dhe veprimet procedurale hetimore të ndërmarra prej tij, nuk janë në kompetencë të Avokatit të Popullit por administrimi i përgjithshëm i çështjeve hyn në kompetencën lëndore të Avokatit të Popullit në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, si dhe Parimet e Komisionit të Venecias për institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut të vitit 2019⁴.

Sipas këtyre parimeve Avokatit të Popullit i është përcaktuar një mandat i gjerë, i bazuar në standardet ndërkombëtare si institucioni më i lartë kombëtar për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Edhe vetë Komisioni i Venecias, duke njohur dhe pranuar parimet themelore të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut të tilla si pavarësia, objektiviteti, transparencë, drejtësia, paanshmëria si dhe duke konsideruar se këto institucione janë një element i rëndësishëm në një shtet të bazuar në demokraci, sundim të ligjit, respektim të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore si dhe qeverisje të mire, ka miratuar parimet mbi mbrojtjen dhe promovimin e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut.

E para dhe më e rëndësishmja që çmon Avokati i Popullit gjatë procesit penal është garancia ndaj abuzimit me kohëzgjatjen e hetimeve. Përfundimi i hetimeve brenda një afati të arsyeshëm në respektim të parashikimeve të Kodit të Procedurës Penal dhe pa shkelje, është në shumë raste elementi thelbësor për një sistem drejtësie të efektshëm dhe për zbardhjen e së vërtetës dhe ndëshkimin e autorit.

Në nenet 323, 324 dhe 325 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet afati 3-mujor i hetimeve që nga momenti i regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale në regjistrin e njoftimit të veprave penale, zgjatjen e afatit të hetimit me tre muaj, por jo më shumë se 2 vjet në raste hetimesh komplekse dhe pamundësie objektive për t’i përfunduar brenda afatit, si dhe të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj zgjatjes së afatit të hetimit nga i pandehuri apo i dëmtuari.

Kjo çështje, e cila ka zgjatur mbi 12 (dymbëdhjetë) vite, (përfshirë periudhat e pezullimit të ndërmjetëm) ka vështirësuar zbardhjen e së vërtetës dhe ka cënuar besimin e personave të dëmtuar, trashëgimtarë të viktimës, si dhe të publikut në përgjithësi në dhënien e drejtësisë. Zgjatja përtej afateve të arsyeshme e procesit ka ndikuar gjithashtu në perceptimin për nivelin e pandëshkueshmërisë dhe ka cënuar të drejtën e trashëgimtarëve të viktimës për një proces të rregullt ligjor.

Veprimet dhe zvarritjet e pajustificuara bien ndesh me nenin 42 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: “*Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj*”.

⁴ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2019\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2019)005-e)

E drejta për një proces të rregullt ligjor parashikohet në nenin 131/f të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Garancitë e parashikuara në nenin 6 zbatohen jo vetëm në proceset gjyqësore, por edhe në fazat që paraprijnë dhe pasojnë ato. Duke qenë një e drejtë kushtetuese, e drejta për një proces të rregullt ligjor e vendos organin procedues para një sërë detyrimesh, si në respektimin e të drejtave procedurale dhe zhvillimin e hetimit e gjykimit brenda një “*afati të arsyeshëm*”, pa lejuar zvarritje të papërligjura dhe arbitrare prej tij. Shpejtimi i procedurave të hetimit dhe gjykimit është i lidhur drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë themelore nga njëra anë, dhe detyrimin për realizimin e një hetimi e gjykimi objektiv, të plotë, të saktë e të shpejtë nga ana tjetër.

Zvarritja e proceseve hetimore është evidentuar si një problem shqetësues në sistemin tonë të drejtësisë. Është detyrë e institucioneve përgjegjëse dhe mbikëqyrëse të këtij sistemi të marrin masa dhe të analizojnë shkaqet që lidhen me cilësinë e hetimeve, me qëllim identifikimin e mangësive, të rasteve kur veprimet procedurale kryhen vetëm në mënyrë formale, apo të rasteve kur numri i veprimeve hetimore mbetet minimal për një periudhë tepër të gjatë kohore.

Kjo problematikë reflektohet edhe si pasojë e reduktimit të ndjeshëm të numrit të prokurorëve në të gjitha nivelet, transferimet e shpeshta brenda strukturave, gjë që ka sjellë cënimin e standardeve të një procesi të rregullt ligjor në të gjitha dimensionet e tij. Situata aktuale paraqitet në kufijtë e një realiteti pothuajse surreal për sa i përket ushtrimit normal të përgjegjësisë dhe kompetencave ligjore nga organet e Prokurorisë, në mbrojtje dhe në garantimin e të drejtave të individëve që cënohen nga vepra të ndryshme penale dhe që kërkojnë mbrojtjen e strukturave shtetërore, një detyrë që në rastin konkret, duhet të ushtrohet nga Prokuroria brenda një afati sa më të arsyeshëm.

Mosgjatja e mjeteve efektive për respektimin e afateve ligjore dhe atyre “të arsyeshme”, si dhe përmasat shqetësuese që kanë marrë praktikat e zvarritura të proceseve hetimore, veçanërisht në proceset më sensitive që kanë tërhequr vëmendjen e publikut, kërkojnë një bashkëpunim më efektiv midis Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, si dhe të gjitha institucionet e tjera përgjegjëse. Sjellim në vëmendje gjithashtu, se rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i infrastrukturës së laboratoreve të institucioneve të ekspertizës, si dhe përdorimi i metodave bashkëkohore, është thelbësore gjatë procesit të hetimeve.

Avokati i Popullit kërkon dhe synon ndërgjegjësimin maksimal të të gjitha strukturave të angazhuara për mbarëvajtjen dhe funksionimin e Sistemit të Prokurorisë, me qëllim që të merren masa efektive, të përshtatshme, të shpejta dhe konkrete për vendosjen në normalitet dhe garantimin e ushtrimit të ndjekjes penale nga Prokuroria brenda hapësirave dhe parashikimeve të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale

Po ashtu dhe në këtë rast theksojmë rëndësinë e transparencës dhe të së drejtës së palëve për informim, si element themelor i një procesi të rregullt ligjor. Rritja e besimit të qytetarëve

në sistemin e drejtësisë mund të arrihet vetëm përmes ndryshimit të qasjes së organit të Prokurorisë në lidhje me informimin dhe njoftimin e qytetarëve.

Avokati i Popullit ka kërkuar në mënyrë të përsëritur nga disa Prokurori pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm⁵ respektimin e të drejtave procedurale të familjarëve të viktimës, nëse atyre u ishte garantuar akses në proces dhe dijeni mbi procedurat hetimore dhe gjyqësore që mund të ishin ndërmarrë, a i është njoftuar vendimmarrja e prokurorit për pezullimin e hetimeve në afat, si edhe gjithçka tjetër që kishte të bënte me çështjen.

Respektimi i të drejtës së palëve për informim nga ana e organit të prokurorisë përbën një nga garancitë themelore të procesit të rregullt ligjor. Organi i Prokurorisë duhet t'i kushtojë rëndësi të veçantë kësaj të drejte, e cila garantohet me ligj, konkretisht në nenin 58 të Kodit të Procedurës Penale "Të drejtat e viktimës së veprës penale" dhe në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Për të gjitha sa parashtroam më lartë, në përputhje me nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime, nenit 8 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 21/b, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar", në të cilin thuhet se: "Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

REKOMANDOJMË:

- *Marrjen e masave me qëllim kryerjen e hetimeve objektive, të gjithanshme dhe të shpejta të procedimit penal nr. 1407/2021, hetuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.*
- *Marrjen e masave nga ana e autoriteteve shtetërore shqiptare si Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, për një ndërveprim të shpejtë, profesional dhe efektiv në ekzekutimin e letërporosive, në kuadër të ndihmës së ndërsjelltë gjyqësore në çështjet penale.*
- *Marrjen e masave për sigurimin e një bashkëpunimi më të mirë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë me institucionin e Avokatit të Popullit, duke rritur transparencën, shmangur burokratitë dhe vonesat e pajustificuara gjatë hetimeve administrative, për përcjelljen e informacionit të saktë dhe dokumenteve hetimore.*

⁵<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandimi%20p%C3%ABr%20respektimin%20e%20te%20drejt%C3%ABs%20p%C3%ABr%20informim%20dhe%20disponimin%20e%20informacionit%20Kor%C3%A7e.pdf>

- ***Marrjen e masave nga autoritetet përgjegjëse për modernizimin e infrastrukturës dhe pajisjeve laboratorike të Institutit të Policisë Shkencore, si dhe forcimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve të specializuara, në mënyrë që ky institucion të jetë në gjendje të përmbushë në kohë dhe me cilësi kërkesat për ekspertizë të organeve të drejtësisë, duke garantuar kështu një proces hetimor të plotë dhe të besueshëm.***
- ***Angazhimin e IPSH-së për standardizimin e metodave të ekspertizës dhe përafrimin e praktikave të Institutit të Policisë Shkencore me standardet ndërkombëtare të laboratorëve simotra, përmes hartimit të protokolleve të unifikuara pune, certifikimit të pajisjeve dhe sigurimit të cilësisë së analizave, në përputhje me kërkesat e BE-së dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në fushën e drejtësisë penale.***
- ***Marrjen e masave për gjetjen e mjeteve efektive për respektimin e afateve ligjore dhe atyre “të arsyeshme” gjatë procedurave hetimore penale, nga institucionet përgjegjëse si Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë i Prokurorisë.***

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, presim përgjigje brenda 30 ditëve në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar i cili parashikon: “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA

D.V.